

HYLLI I DRITËS

Ubi Spiritus Domini, ibi libertas
(II. ad Cor. III. 17).

VOTER
KULTURE
SHQYPTARE

3-4

Marc - Prill 1942-XX.

VJETI XVIII.

S H K O D E R

Pajtimi per të perkohshmen „HYLLI I DRITËS“

Shqypai	Nji numer Fr. 1.00	Nji vjetë Fr. 10.—
Itali	» » » 1.00	» » » 10.—
Nder vende tjera . .	» » » 1.40	» » » 14.—

Themelue në vjetin 1913 prej At Gjergj Fishta

PERMBAJTJA

Pastor Angelicus	PAGE 97
G. S. — Fatosavet të harruem	101
F. S. NOLI — Shpell' e Dragobisë	102
F. S. NOLI — Syrgjyn Vdekur	103
M. N. — Dom Gjon Gazulli	104
A. PASHK BARDHI o. f. m. — Emzot Prend Doçi	107
N. B. — Vakëfi	142
Dr. EGREM ÇABEJ — Diana dhe Zana	144
G. STADTMUELLER — Historija Shqiptare	149
P. ANTON HARAPI — Valë mbí valë	159
Dr. VASFI SAMIM VISOKA — Gjëndja e blegtoris shqiptare në kohën e luftës të sotëshme	166
GELASIUS — Fjalori Toponomastik	176
GJUSH SHELDIJA — Shiroka e gjuetija e peshkut në liqë të Shkodres e në lumin Buenë, Dri e Kir	180
KUNDRIME LETRARE — G. S. Libra shtetit per shkolla të mjesme	186
KUNDRIME SHKENCORE — G. S. Mosbarasimi i natyr- shem e jeta shoqnore	188
KUNDRIME BOTNORE — SH. Çka është Europa?	189
P. D. KURTI — Prralla. — Blë. II. Fash. 10.	

HYLLI I DRITËS

E PERKOHËSHME KULTURALE-LETRARE

Pastor Angelicus.

Nji herë fillue, vijue pa u këputun kurr per me jetue deri në të shkimun të shekujvet, rrin e sundon madhnueshem në Selin Shëjte Sherbtori i sherbtorvet të Zotit, Papa.

Nder kohë të ndryshme, me ëmna të ndryshem, por nji per kah mënyra e veprimit e per shka i perket substancës së mësimit, Papët kjenë gjithë per të gjithë.

Dielli qi shndritë, qi nxën, qi ep jetë nuk njeh e nuk bân ndryshim mbi kurrgjâ. Rrezet e tija shperdahen rrethas e drejtohen pingultas mbi gjithshka të ndeshin. Papa është e vetmja pikë e zjarrët, në të cillen ndryshimet e rracavet e të dasivet njerzore sublimohen. Dr. Wirth, protestant tue kënë, shkruete në fletoren „Tag“ nji artikull me titull „Pozicjoni i Papës“, në të cillin nder sa tjera thote: «Mue si historjak e si protestant më duhet të rrëfej se fuqija e Papës shkon tue marrë hov e tue u ardhun rreth dishirevet e nevojëvet të tanë popujvet... Historija e pa-anëshme difton se Papët vepruen me dobi per të gjitha fiset e botës.»

Në kje se marrë bota e sodshme, sado e dame dysh prej këtij konflikti në vazhdim, kremton njillojtas tue shprehë bindin e nderimin ndaj Piun XII per festimin e 25 vjetorit t' episkopatit të Shëjtnis së Tij, edhe këjo bota e vogel shqyptare e jona nuk ka si të tërhiqet tue mos perkujtue me evari sidomos nder këto kohët e mbrame bamirësit e mdhaja qi pat prej Selis Shëjte.

